



Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës  
Press Council of Kosovo  
Savet Štampe Kosova

**06.11.2017, Prishtinë,  
Ref:09.10.2017\568-2017**

**Opinion i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës ndaj  
ankesës së Devolli Group kundër Kosovës Sot**

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 31 tetor 2017, shqyrtoi ankesën e Devolli Group kundër gazetës Kosova Sot lidhur me artikullin "Autoriteti i konkurrencës meriton shkarkim" të datë 27.09.2017, dhe nxori këtë

O P I N I O N

- Ankesa miratohet

## A R S Y E T I M I

Në ankesë thuhet se artikulli boton shumë akuza kundër vllezërve Devolli të cilët, siç thuhet "ia kanë mbyllur gojën me para të gjitha partive politike, çdo institucioni dhe çdo medie në Kosovë".

Këto akuza të përgjithësuara kundër një kompanie pa paraqitur fakte të prekshme krijojnë paqartësi. Ato do të ishin të besueshme sikur të mbështeteshin me fakte, të cilën e kërkon edhe Kodit i Mediave të Shkruara të Kosovës.

Gazeta është dashur të mbledhë sa më shumë fakte për të dëshmuar se si këto subjekte të përmendura janë shëndruar në shërbëtorë të Devollëve.

Andaj Bordi i KMSHK vendosi se është shkeur Kreu II (Raportimi i së vërtetës), dhe Kreu IV( E drejta për t'u përgjigjur), pasi nuk i është mundësuar palës tjetër ta paraqes prononcimin e vet ndaj këtyre akuzave.

Andaj, opinionimi u nxor me shumicën absolute të votave të anëtarëve prezent.

Bazuar në atë që u tha më lartë, KMSHK vendosi si në dispozitiv të këtij opinionimi.

**Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës**